

AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

Pozicionet drejtuese që janë subjekt deklarimi pranë AIDA-s

1. Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s

Znj. Laura Plaku (Saro) është emëruar Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s me vendimin e Bordit Drejtues nr. 1, datë 14.09.2023. Znj. Plaku është diplomuar në fushën e Drejtësisë pranë Universitetit të Kent, Canterbury, Mbretëria e Bashkuar dhe Universitetit të Kent, Bruksel, Belgjikë. Znj. Plaku zotëron licencën e Avokatit dhe ka një eksperiencë të gjatë në fushën e konsulencës ligjore dhe menaxhimit.

Ndër përvojat e saj të shumta rezulton dhe mësimdhënia në fushën akademike, si dhe ekspertiza ligjore.

Znj. Plaku gjatë eksperiencës të saj 11 vjeçare në fushën e drejtësisë ka ndjekur trajnime dhe kualifikime të shumta.

Znj. Plaku është gjithashtu njohëse e 4 gjuhëve të huaja.

Adresa e-mail: laura.plaku@aida.gov.al

2. Drejtor i Drejtorisë së Investimeve Strategjike

Znj. Mileva Meksi është e emëruar në këtë detyrë nga muaji shtator 2019. Ndërkohë që është punonjëse e AIDA-s nga viti 2012, ku ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit After Care, Drejtoria e Investimeve.

Në vitin 2007 ka mbaruar studimet e larta për Drejtësi në Universitetin “Luarasi”, Tiranë. Gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer trajnime të shumta në fushën e jurisprudencës. Me një eksperiencë mbi 15 vjeçare në pozicione të ndryshme në nivel drejtues në institucione publike si koordinator projektesh me fonde te BE, asistent në Kabinetin e Ministrit të Shëndetësisë, etj. Znj. Meksi është gjithashtu dhe njohëse e tre gjuhëve të huaja.

Adresa e-mail: mileva.meksi@aida.gov.al

3. Drejtor i Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit

Znj. Ornella Gjini është emëruar në këtë pozicion nga viti 2025. Znj. Gjini ka përfunduar studimet e larta në vitin 2014 pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Politike, të universiteti Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë”. Gjithashtu, është diplomuar në fushën e Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale, master shkencor në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Znj. Gjini ka eksperiencë disa vjeçare në fushën e ekonomisë dhe të Investimeve të Huaja Direkte. Gjatë eksperiencës së saj të punës 12-vjeçare pranë AIDA-s ka ndjekur trajnime dhe kualifikime të shumta në fushën ku aktualisht është drejtor.

Adresa e-mail: ornella.gjini@aida.gov.al

4. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve, NVM dhe Eksporteve

Znj.Fiona Beqiri është emëruar në këtë pozicion nga viti 2025. Znj Beqiri ka përfunduar studimet e larta në vitin 2020 në Studim Biznesi me specialitet financë pranë City University of London, Mbretëri e Bashkuar. Gjithashtu, është diplomuar në fushën e Financë dhe Kontabilitet, master i shkencave në City University of London dhe aktualisht Znj.Beqiri është studente në Programin e Studimit të Doktoraturës në “Shkenca Ekonomike”, nënfusha “Financë” në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Më tej, ajo ka eksperiencë disa vjeçare në fushën e ekonomisë, si dhe prej 3 vitesh është e emëruar pranë Drejtorisë së Projekteve, NVM dhe Eksporteve.

Adresa e-mail: fiona.beqiri@aida.gov.al

5. Drejtor i Drejtorisë së Marketing

Znj. Dildirus Vrioni është e emëruar në këtë pozicion nga vitin 2019. Znj. Vrioni ka përfunduar studimet e larta në vitin 2008 pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. Gjithashtu është diplomuar në fushën e shkencave politike, master profesional, në Universitetin e Parisit 8, Vincennes Saint – Denis, Francë. Aktualisht është duke ndjekur studimet për mastër shkencor në degën Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, pranë Universitetit të Studimeve Europiane, Tiranë. Znj. Vrioni ka eksperiencë disa vjeçare në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit në sektorin publik. Gjatë eksperiencës të saj të punës 9 vjeçare ka ndjekur trajnime dhe kualifikime të shumta në fushën ku aktualisht është drejtor.

Adresa e-mail: dildirus.vrioni@aida.gov.al

6.Drejtor i Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Znj. Erisa Ymerali është emëruar në këtë detyrë në muajin shkurt 2023. Në vitin 2008 ka mbaruar studimet e larta në Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Kontabilitet Financë. Ka kryer trajnime të ndryshme në fushën e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar. Me një eksperiencë mbi 15 vjeçare në institucione publike qendrore, në pozicione të ndryshme në nivel drejtues në fushën e menaxhimit të burimeve financiare. Njohëse e dy gjuhëve të huaja.

Adresa e-mail: erisa.ymerali@aida.gov.al

